



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA LIPJAN
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Komuna Lipjan shpall:

Konkurs

Pranim

[Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.](#)

Emri i grupit	Specialistë të inxhinierisë të Ndërtimit
Titulli i pozitës së punës	Zyrtar për Menaxhimin e Projekteve
Klasa e pozitës	Profesional 2
Koeficienti/Paga	GJ12-6.54
Nr. i kërkuar	3
Data e njoftimit	29/11/2023
Afati për aplikim	30/11/2023 - 29/12/2023
Institucioni	Komuna Lipjan
Departamenti	DREJTORATI PËR INFRASTRUKTURË
Divizioni	
Vendi i punës	Zyrtar për Menaxhimin e Projekteve
Nr. i Referencës	RN00012891
Kodi	RPC0006430



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Bënë përgatitjen e projekteve ideore/propozuese/për ndërtim.
2. Bënë monitorimin dhe mbikqyrjen e projekteve të infrastrukturës Komunale.
3. Kujdeset për zbatimin e kontratave gjatë implementimit të projekteve të infrastrukturës.
4. Kujdeset për përcjelljen dhe mbikqyrjen e projekteve gjatë implementimit sipas paramasave dhe parallogarive të dhëna në ofertë dhe harton raportet me shkrim për punët në teren.
5. Kujdeset për përcjelljen e pagesave të projekteve në bazë të situacioneve dhe në bazë të kontratës.
6. Bënë hartimin e paramasave dhe parallogarive sipas kërkesave dhe kërkon shpalljen e tenderëve nga Drejtorati për Pokurim.
7. Merr pjesë në hapjen dhe vlersimin e ofertave tenderuese kur caktohet nga udhëheqesi i sektorit.
8. Njofton udhëheqesin për ndryshimet eventuale në projekt gjatë implementimit,
9. Bënë pranimin teknik të objekteve të përfunduara të infrastrukturës kur emrohet nga shefi i sektorit.
10. Për punën e tij-saj i përgjigjet dhe i raporton Udhëheqesit të Sektorit.
11. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.



3. Kërkesat e përgjithshme formale

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Fakulteti i ndërtimtarisë, arkitekturës, elektros dhe Hidro teknikës.
- **Kualifikime të posaçme formale:** //
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 13/01/2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Kriteret specifike shtesë

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

//

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

